



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë  
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë  
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency  
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu











## FTESË PËR BIZNESE

Forumi i Biznesit ndërmjet Kosovës dhe Kroacisë  
B2B takime mes bizneseve kroate dhe bizneseve kosovare

13 Dhjetor 2024  
Zagreb, Kroaci

Me qëllim të promovimit të kompanive kosovare në gjetjen e tregjeve të huaja dhe rritjes së gamës së produkteve për eksport, si dhe tërheqjes së investimeve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) dhe në bashkëpunim me institucionet përkatëse, fton bizneset vendore për pjesëmarrje në forumin ekonomik që do të mbahet me 13 Dhjetor 2024 në Zagreb, ndërmjet Kosovës dhe Kroacisë. Fokus të veçantë në këtë forum do të kenë takimet B2B ndërmjet bizneseve kosovare dhe bizneseve kroate, si rezultat i bashkëpunimit ndërmjet KIESA-s dhe agjencisë homologe kroate.

Forumi ekonomik ka për qëllim thellimin e bashkëpunimit bilateral dhe për të krijuar lidhje në mes ndërmarrjeve kosovare dhe atyre kroate, për të hapur mundësi të reja për rritje të bashkëpunimit në fushën e investimeve dhe eksporteve. Bizneset vendore të ftuara për pjesëmarrje në forum, janë nga sektorët si në vijim:

-  Industria e Energjisë
-  Industria e Transportit (transporti hekurudhor)
-  Industria Metalike
-  Industria Jo-Metalike
-  Industria e Drurit
-  Industria e Ushqimit dhe Pijeve
-  Industria e Tekstilit
-  Industria e Plastikës
-  Industria Kimike
-  Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK – ICT)

Për të qenë pjesë e forumit ekonomik dhe takimeve B2B, bizneset duhet dorëzuar dokumentet si në vijim:

1. Aplikacionin e plotësuar më të dhënat bazike të biznesit;
2. Dëshminë që biznesi është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
3. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të biznesit dhe
4. Deklaratën nën betim.

Dokumentet e lartpërmendura duhet t'i dërgojnë në mënyrë elektronike më së largu deri më 05.12.2024 në orën 00:00, në e-mail adresën si në vijim:

⇒ [invest.kiesa@rks-gov.net](mailto:invest.kiesa@rks-gov.net)

Informata shtesë rreth aktivitetit mund të merren në MINT/KIESA përmes linjave telefonike si në vijim:

⇒ +383 (38) 200 36 585

⇒ +383 (38) 200 36 542